

ΤΙΤΟΣ Π. ΓΙΟΧΑΛΑΣ, ΑΝΔΡΟΣ - ΑΡΒΑΝΙΤΕΣ ΚΑΙ ΑΡΒΑΝΙΤΙΚΑ. Εκδόσεις Πατάκη, Αθήνα 2000, σσ. 520 + 124 φωτογραφίες. [Titos P. Johalas, *Andros - Arvanitët dhe Arvanitishija*. Botimet Pataqi, Athinë 2000, ff. 520 + 124 fotografi].

Në librin e tij *Αρβανίτικα παραμύθια και δοξασίες [Përralla dhe besime Arvanitase]*, botuar në Athinë më 1977, studiuesi i mirënjohur dhe lëvruesi i pasionuar e sistematik i albanologjisë në Greqi, Dr. Titos Johalas, na pati gëzuar me njoftimin se tekstet origjinale të traditës gojore arvanitase, të cilat në librin e lartpërmendur jepeshin vetëm në përkthimin greqisht, do të botoheshin «në serinë e monografive përkatëse që do të pasojnë e që do të ndjekin kriterin gjeografik»¹.

Fjalëpak e punëshumë Johalasi nuk na «rrejtji». Tre vjet më vonë, me librin *Άνδρος - Αρβανίτες και Αρβανίτικα*, ai na zbulon një pjesë të thesareve të shqipes që ruhen në gji të dheut helen dhe na bën ta mbajmë për një çast frymën (prej ngazëllimit dhe admirimit!) kur shkruan se ka në procesin e botimit dhe së shpejti pritet të qarkullojë edhe katër monografi të tjera, me objekt të mirëfilltë arvanitasit, gjuhën dhe traditat e tyre. Po qe se i shtojmë këtij numri edhe librat tashmë të botuar të autorit (duke lënë mënjane artikujt e shumtë nëpër revista shkencore), na del se ato janë më tepër se një duzinë dhe se e kanë pasuruar ndjeshëm bibliotekën albanologjike². Gjithashtu, po qe se edhe monografitë e tjera do të kenë cilësinë e kësaj për ishullin Andros, e themi me bindje se Johalasi e meriton plotësisht të mbajë kryet e vendit ndër studiuesit e sotëm të botës arvanitase dhe të jetë një pikë referimi për më të rinjtë.

Në të vërtetë, kam përshtypjen se punimet e deritashme të Johalasis, megjithë rëndësinë e padiskutueshme shkencore të tyre, kanë

¹ Shih edhe recensionin tonë në revistën *Universi Shqiptar i Librit*, 4 (7) 1998, f. 44-45.

² Përmendim ndër të tjera «Über die Einwanderung der Albaner in Griechenland», në serinë *Dissertationes Albanicae*, München 1971, O Γεώργιος Καστριώτης - Σκεντέρμπεης εις την Νεοελληνικήν Ιστοριογραφίαν και Λογοτεχνίαν, Θεσσαλονίκη 1975, β' έκδ. Αθήνα 1994, Το Ελληνο-Αλβανικό Λεξικό του Μάρκου Μπότσαρη, Φιλολογική έκδοσις εκ του αυτογράφου, εν Αθήναις 1980, β' έκδ. Αθήνα 1993, Στοιχεία ελληνο-αλβανικής γραμματικής και ελληνο-αλβανικοί διάλογοι. Ανέκδοτο έργο του Ιωάννη Βηλαρά. Φιλολογική έκδοσις από τον αυτόγραφο κώδικα της Εθνικής Βιβλιοθήκης των Παρισίων. Θεσσαλονίκη 1985, Αλβανολογία και ερασιτεχνισμός. Αποκατάσταση αρβανίτικων κειμένων, Αθήνα 1988, Ελληνικά επώνυμα, ονόματα και τοπωνύμια των αλβανικών κοινοτήτων της Κάτω Ιταλίας και της Σικελίας, Αθήνα 1993, «Considerazioni sull'elemento Greco nell'arbëresh», në *I dialetti Italo-Albanesi*, Roma 1994, Αλβανο-Ιταλικά, Αθήνα 1996, Αρβανίτικα παραμύθια και δοξασίες - Νεράιδες, δαίμονες, ξόρκια, ψυχιάσματα, Αθήνα 1997, Στη γη του Πύργου, Διαχρονικός Ελληνισμός στην Αλβανία, κείμενα: Τίτος Π. Γιόχαλας, φωτογραφίες: Λ. Έβερετ, Αθήνα 1993.

qenë më tepër një «nxemje», një fazë në thelb përgatitore për t'u zhytur më pas në thellësitë e kohëve dhe të shqipes.

Me monografinë që po prezantojmë këtu, studiuesi Johalas është përpjekur të bëjë një trajtim të shumanshëm, jo vetëm gjuhësor, të popullsisë arvanitase që u ngul në ishullin Andros qysh në kohë të Mesjetës.

Kreu i parë i librit, me titull *Ta ιστορία [Të dhëna historike]*, f. 13 – 70, del nga caqet e një trajtimi të ngushtë historik duke hedhur dritë edhe në aspektin folkloriko-etnografik të kësaj popullsie. Krahas informacionit historik për kohën e vendosjes së arbërve në ishull (duke ndërthurur të dhënat e marra nga burime të ndryshme, autori arrin në përfundimin se kjo ndodhi në kapërcyell të shekujve XIV dhe XV) Johalasi ndalet edhe në procesin e integritit të tyre gjatë periudhës para dhe pas Revolucionit të 1821-it. Citohet udhëtari de Thenevot, sipas të cilit më 1664 ata flitnin një gjuhë të ndryshme nga greqishtja dhe jetonin me zakonet e doket tyre. Kur shpërtheu Revolucioni, shkruan Johalasi, ishte kryer ndërkaq shndërrimi gradual dhe i pashmangshëm i arbërve në arvanitas e rrjedhimisht në grekë që do të marrin pjesë në Kryengritjen “për jetë a vdekje” të “kombit”³. Në vazhdim mësojmë se shtyllat e ekonomisë shtëpiake të arvanitëve të ishullit Andros kanë qenë bujqësia dhe blegtoaria, se buka nuk nxirrej lehtë në arëzat gurishte të ishullit, ndaj dhe beja e tyre më e shenjtë ishte *prë bukëzë!*. Jepen të dhëna për profesionet, prodhimet dhe ushqimet e banorëve arvanitas të ishullit. Autori vëren, p.sh., se ndër produktet natyrore «barishtet e egra kanë qenë për arvanitët një ushqim bazë dhe madje jo vetëm për vitet e para të vendosjes së tyre në ishull». Kjo, shton ai, duket edhe nga qëndresa dhe mbijetesa e emërtimeve shqip të tyre, që bëjnë pjesë në leksikon bazë e të kryehershëm të shqipes. Veshjet dhe mënyra e të krehurit, organizimi shoqëror, gjendja e arsimit trajtohen në mënyrë asimetrike brenda këtij kreu, sigurisht sipas materialit të disponueshëm. Tërheq vëmendjen ndër të tjera një letër e ministrit grek të Arsimit (26 gusht 1845), ku bëhet fjalë për çeljen e shkollës fillore në fshatin Arni, banorët e të cilit, «edhe pse grekë nuk e njohin fare greqishten dhe flasin të gjithë shqip». Me interes janë gjithashtu edhe të dhënat për ndërtimet e ndryshme (banesa, kulla, kisha, mullinj, lëmenj prej guri, tarraca, etj.). Duke i kundruar sot këto ndërtime, shkruan autori, «e marrim me mend sa orë të pafundme pune të mundimshme dhe sa djersë u janë dashur atyre kalorësve të shkathët të shekullit XV për t'u shndërruar më pas edhe në bujq të mirë».

³ ... η μετάλλαξη των Αλβανών σε Αρβανίτες και συνεπώς σε Έλληνες. Këtu autori bën fjalë për përfitim të ndërgjegjes kombëtare nga ana e arvanitëve.

Kreu i dytë, me titull *Ta γλωσσικά [Të dhëna gjuhësore]*, f. 71-128, çelet me analizën e emrave të fshatrave e të vendbanimeve arvanitase të ishullit. Lënda është e pasur dhe interesante, krahas elementit të shqipes një vend të konsiderueshëm zë edhe elementi grek (shih p.sh. *Ledbëza, Lekanj, Likura, Lopësi, Lumëzi, Palokroi, Pelgu i zi, Rrethi, Rreth i trashë, Shkëmbi, Shkëmbi kuq, Shpella plaku, Traçi thellë, Vorri, Vreshtë, etj., dhe Lefka, Lutro, Llambadhetë, Mesonisi, Mikrojali, Peristerjona, Psolimjona*, e shumë të tjera). E njëjta përzierje vihet re edhe në antroponimet, e sidomos në mbiemrat, ku gjurmët e shqipes janë të dukshme (*Βλάμης [Vllami], Γκούμας [Guma], Δάρας [Dara], Κοροβέσης [Koroveshi], Κρίπας [Kripa], Ρέρας [Rëra], Ρίπης [Rripë], Μάζης [Mazë], Μπάλας [Balla]*, etj.).

Duke shqyrtuar ndikimin e greqishtes në arvanitishten e Androsit, i cili është i madh dhe shumëplanësh, autori vëren se, megjithatë, «është ruajtur e paprekur bërthama bazë e fjalorit të shqipes si dhe struktura gramatikore dhe sintaksore e saj». Huazimet nga greqishtja ndahen në tri kategori: njëra përfshin elementin leksikor grek që arvanitasit e Androsit e prunë nga vatrat e kryehershme të tyre, tjetra lëndën e re leksikore të marrë nga e folmja e ishullit, e treta fjalët e marra nga greqishtja letrare. Pas listave të fjalëve për secilën kategori, Johalasi shtron pyetjen a ka patur huazime edhe në kahje të kundërt. Fjala *μπροστούλας*, p.sh., arriti të depërtojë dhe të zërë vend në tryezat e banorëve të ishullit (<*brushtull*), ndërsa fjalë të tjera (*μπαμπέσης, φάρα, τσουράπια*) mbërritën në greqishten e ishullit nëpërmjet greqishtes letrare (*νεοελληνική κοινή*). Duhet thënë, ndërkaq, se përfshirja e fjalëve në këtë apo atë kategori përmban shpesh njëfarë subjektiviteti, ngaqë kriteret nuk janë gjithnjë të qarta.

Pasi jep lista me huazime nga italishtja dhe turqishtja, që përdoren në arvanitishten e ishullit, autori i hyn analizës së faktorëve që çuan në rrëgjimin e saj, sidomos gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Ndërsa deri në shekullin XIX arvanitishtja ishte organi kryesor i komunikimit mes banorëve arvanitas, gjatë shekullit në vazhdim, si rezultat i braktisjes së ekonomisë tradicionale (bujqësi, blegtori) një pjesë e madhe banorësh të këtyre fshatrave zbresin në qendrat me popullsi mikste të ishullit, por edhe më tej. Burrat fillojnë të merren me detari, ndërsa vajzat e reja preferojnë të shkojnë nëpër qytete (Athinë, Stamboll, Izmir, Aleksandri), ku punësohen si dado pranë familjeve të pasura. Nga momenti, pra, që thuhet «guaska» e jetës së mbyllur të këtyre vendbanimeve, është e pritshme që të ndryshojë edhe statusi i arvanitishtes. «Sot, shkruan autori, askush në këto fshatra, popullsia e të cilëve është rralluar së tepërmi, nuk komunikon vazhdimisht në të folmen arvanitase. Çifte të moshuarish, nganjëherë dhe më të rrallë, mund të shkëmbejnë disa fraza të shkurtra, por e folme e qendrueshme dhe e vazhduar në arvanitisht nuk haset» (f. 109).

Mungesa e folësve aktivë ka qenë një ndër vështirësitë kryesore me të cilat iu desh të përballet autorit. Në këtë kuptim, «tekstet dhe glosari i arvanitshes që po botojmë marrin rëndësi të veçantë pikërisht sepse i përkasin një gjuhe që po zhduket por që është folur nga një e treta e popullsisë së ishullit Andros. Në të jo vetëm që u kristalizuan dukuri tejet interesante për historinë e shqipës dhe të greqishtes, por edhe elemente të tjera folklorike, etnografike, historike dhe përgjithësisht kulturore, të cilat formojnë tablonë tërheqëse, shumëngjyrëshe, ndërkulturore të realitetit grek, ballkanik dhe mesdhetar» (f. 110).

Në vazhdim autori jep karakteristikat kryesore të kësaj të folmeje (të vihen re p.sh. tiparet arkaike si ruajtja e grupeve *kl* e *gl*, apo e të tri gjinive) dhe, pasi konstaton se ajo afron më shumë me toskërishten, ndalet më tej në veçantitë e të folmeve të disa fshatrave. (Lënda është e pasur, kështu që ne do ta cekim pjesërisht duke bërë edhe ndonjë vërejtje dashamirëse). Me interes janë tipat *e bekuame* dhe *ma*, të cilët, më tepër se gjurmë të gegërishtes, tregojnë për një afri më të madhe të dy grupeve kryesore dialektore të shqipës gjatë Mesjetës. Trajta *ba* (117) është për mendimin tonë variant i *brenda*, ashtu si *bënda* dhe *mënda* (114), ndërsa trajta *tra* e numërorit *tre* (117) nuk na duket të jetë rrjedhojë e përngjashmimit (asimilimit) prapavajtës (*tre-katrë* > *trakatrë*) sesa e një *krasis* (*tre a katër* > *tra-katër*, khs. *një a dy* > *nja dy*). Kjo përforcohet edhe nga fakti, që, siç thotë autori, ajo haset gjithnjë në çiftin *tra-katrë*. Po kështu, trajta *qimbe* nuk përbën veçanësi leksikore (sikurse *dimër* në kuptimin 'shi' dhe *grikë* në kuptimin 'gojë'), meqenëse këtu nuk kemi ndryshim kuptimi, por vetëm një variacion fonetik të njohur të shqipës. Në trajtat *d'e ziej*, *d'e piksi* etj. nuk kemi të bëjmë me sonorizim të pjesëzës *të* të lidhores (121), por me trajta të rrëguara të pjesëzës *do* të futurit: *do e ziej* => *d'e ziej*, *do e piks* => *d'e piks*. Kjo duket qartë edhe nga tekstet e dhëna prej autorit: *Do marr klumushtitë, d'e piksi t'e bëj djathë* (389), *Sterna [pastaj] d'e ziej të bëj gjizënë* (484). Po kështu, trajta *dhromi* në mallkimin *të mbetej dhromi* (121) [khs. *mos arri/sh / ardh/sh*] mund të jetë një rrjedhore pa mbaresën *-t* (krahaso ndajfoljet *pl* dhe *sinje* të kësaj të folmeje, f. 112, por edhe përdorime si *Shirvasili [=shënvasilit 'ditën e shënvasilit'] bëjnë jetrë, bëjnë pita*, f. 136), pa u përjashtuar mundësia që, siç thotë autori, të kemi një përdorim pa parashtesë, si në rastet *do vemi katundi* [=në katund] (121), etj.

Kreu i tretë, *Αρβανίτικα κείμενα και τραγούδια της Ανδρου* [Tekste dhe këngë arvanitase të ishullit Andros], që shtrihet në faqet 129-192, përmban 70 tekste e fragmente këngësh, shoqëruar me përkthimin greqisht të tyre. Janë çaste nga jeta e përditshme e banorëve të fshatrave arvanitase, nëpërmjet të cilave krijojmë një ide të arvanitshes së ishullit, por edhe

të punëve të vështira që përbënin strumbullarin e jetës së tyre: bujqësi, blegtori, bletari, gatim buke, vegjitari.

Kreu i katërt, *Αρβανίτικο γλωσσάριο της Άνδρου* [*Glosar i arvanitishtes së ishullit Andros*], qoftë për nga shtrirja (f. 193-487) qoftë për nga informacioni përbën "thesarin" e monografisë së Johalazit. Trajtat e njësive leksikore renditen në bazë të afrisë me shqipen letrare. Kur një fjalë ndryshon ndjeshëm nga gjegjësjë e shqipes së sotme, ajo hyn si lemë më vete. Prej qindra e qindra fjalëve (dhe prej mijëra trajtave - shih p.sh. *nuk, nëk, nëkë, kë, k', nuku, nukë*) që përfshin glosari, ne do të ndalemi në mënyrë selektive vetëm në disa sosh.

arberistiqe -të (trajta *alburistiqe, arburiste*) 'arbërisht': *Di arburistetë?*. Me të njëjtin kuptim përdoren edhe fjalët *arvani -të, arvanitika -të, arvanitqe -të*. *Ksillone arvanitqe? U dite arvanitqe*. Folja *bredh (bredhte)* përdoret me kuptimin 'loz', fjala *dimër* me kuptimin 'shi' (të vihet re diferencimi kuptimor midis fjalës anase dhe huazimit nga greqishtja: *Ama shkundetë pula e është hjimonë [=dimër], do të kemi dimër [=shi]*). Po kështu, *gátém 'sëmurem', gáti, i gátë, i gáturë 'i sëmure'*: *Djali është gati [sëmure]*. Fjala *grurë* '1. grurë 2. përshpirtje', emri *dalandish* ka ruajtur kuptimin 'bigëz', ndërsa për 'dallëndyshe' përdoret huazimi *hjelidhón, njëditëz* në kuptimin 'pardje' dhe *skanjëditëz* 'parpardje', *dej* 'pasnesër', *skodëj* 'paspasnesër', *vjet* 'vjet' dhe *vjetë* 'mot', *shqërte* 'çjerr, gris'. 'Bën përshtypje gjithashtu edhe ruajtja e sistemit vigesimal të numërimit, tej njëzetës dhe dyzetës: *trezë, katrëzë* etj., etj.

Pas kreut të katërt, në faqet 489-500, një shtojcë me titull *Αλβανοί της Άνδρου στην Contessa Entellina της Δυτικής Σικελίας* [*Shqiptarë nga ishulli Andros në Contessa Entellina të Sicelisë Perëndimore*] e bën më të plotë kuadrin historik të ngulimeve dhe të zhvendosjeve të kësaj popullsie, dhe në këtë kuptim mund të konsiderohet si pjesë e kreut të parë. Kjo shtojcë, por edhe referimet e shpeshta të autorit nga bota e arbëreshëve të Italisë, ia pasurojnë vlerat librit, duke i dhënë edhe një përmasë krahasuese. Johalasi shfaqet kështu si njohës nga më të mirët i dy arealeve kryesore të diasporës mesjetare shqiptare, të cilat, siç dihet, kanë mes tyre lidhje të ngushta historike e gjuhësore.

Një lëndë kaq e gjerë lë sigurisht shteg për vërejtje të pjesshme, gjithnjë në sens pozitiv. Mendojmë se mund të ishin shmangur disa përsëritje (p.sh. në faqet 93 dhe 96 hasim në konstatimin se një pjesë të elementit leksikor grek arvanitasit nuk e morën në Andros, por e pranë nga atdheu i parë i tyre). Në *Glosar*, disa trajta që paraqiten si lema të ndryshme do të mund të ishin përfshirë në të njëjtën lemë (shih p.sh. *shqëte* 'hedh' dhe *shtë, shtëte* 'hedh', *fértëtë* dhe *vértëtë*, etj.), në zbatim të kriterit të ndjekur për të vënë në krye trajtën më të afërt me shqipen letrare, do të pritej që në vargun e trajtave *nëk, nëkë, kë, k', nuku, nukë, nuk* (f. 369), trajta e vendosur në fund të shfaqej e para, etj.

Pa u zgjatur më tej me shembuj e vërejtje, besojmë se është e qartë sa e vlefshme është lënda e këtij libri për etimologjinë, leksikologjinë dhe morfologjinë historike, për dialektologjinë, sociolinguistikën e fushat e tjera të shkencës gjuhësore. Së bashku me shkrimtarët e vjetër të veriut, këto tekste ngjajnë me një laborator të gjallë, ku gjejmë fenomene gjuhësore nga më interesantet, herë "të ngrira" në kohë herë të evoluara në një kahje tjetër.

Jemi të mendjes se ka ardhur koha për një rrokje tërësore të të folmeve arvanite të Greqisë, e cila për fat të keq deri më sot na ka munguar⁴. Megjithatë, ajo është e pamundur të kryhet nëse mungojnë studimet për zona të caktuara. Në këtë kuptim, ndihmesa e T. Johalazit është tepër e çmuar. Le t'i urojmë punë e penë të mbarë për të sjellë sa më shpejt në dritë veprat e premtuara.

DHORI Q. QIRIAZI

⁴ Punimi premtues i H. J. Sasse-s *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland*. Teil 1. Wiesbaden 1991, ku për herë të parë bëhej një përpjekje për paraqitjen tërësore dhe në sistem të të folmeve arvanitase, ka mbetur ende në vëllimin e parë, ndonëse u mbushën plot dhjetë vjet nga botimi i tij. Autori njoftonte me atë rast se vëllimi i parë do të pasohej nga tre të tjerë (II. Paraqitje e të folmeve të tjera arvanitase, me pikë referimi të folmen e Atiko-Beotisë III. Vështrim sociolinguistik IV. Fjalor).